



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada-Government

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke, Tehnologije i Inovacije
Ministry of Education, Science, Technology and Innovation

Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), bazuar në Ligjin 02/L-67 për botimin e teksteve shkollore dhe mjeteve mësimore dhe Vendimin nr. 3178 të datës 05.12.2022, për hapjen e konkursit për tekste shkollore për klasat (I-V) në lëndët që kanë vetëm një tekst shkollor në përdorim.

SHPALL

KONKURS PËR TEKSTET SHKOLLORE DHE MATERILAET

MËSIMORE

Rishpallje për tekstet të cilat nuk kanë kaluar në procesin paraprak

Fusha kurrikulare	Lënda	Teksti shkollor/materiali mësimor	Klasa
Gjuhë dhe komunikim	Gjuhë shqipe	Gjuhë shqipe	5-të
Artet	Edukatë muzikore Edukatë figurative	Edukatë muzikore Edukatë figurative	2-të, 3-të 1-rë, 2-të, 3-të
Matematikë	Matematikë	Matematikë	1-rë, 3-të
Shkencat natyrore	Njeriu dhe Natyra	Njeriu dhe Natyra	1-rë, 2-të, 3-të
Shoqëria dhe mjedisi	Shoqëria dhe mjedisi	Shoqëria dhe mjedisi	
Jeta dhe puna	Shkathtësi për jetë	Shkathtësi për jetë	5-të
Edukata fizike, sportet dhe Shëndeti	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	Edukata fizike, sportet dhe shëndeti	1-rë, 2-të

1. KRITERET E APLIKIMIT DHE PËRZGJEDHJES

Përzgjedhja e dorëshkrimeve për botim zhvillohet në tri faza: paravlerësimi, vlerësimi dhe vendimi për botim. Çdo dorëshkrim do të paravlerësohet për t'u siguruar që kërkesat themelore janë plotësuar dhe se janë në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet e mëposhtme:

1. Ligjin për botimin e teksteve shkollore, mjeteve mësimore, lektyrës shkollore dhe të dokumentacionit pedagogjik.
2. Kornizën Kurrikulare të Kosovës.
3. Kurrikulat bërthamë:
 - 3.1 Për klasën përgatitore dhe arsimin fillor
4. Plan-programet lëndore.
5. Standardet për tekste shkollore.

Dorëshkrimet të cilat në fazën e paravlerësimit konstatohet se nuk janë në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet e lartpërmendura, nuk kalojnë për shqyrtim në fazën e dytë të vlerësimit.

2.1 KËRKESA TË PËRGJITHSHME PËR DORËSHKRIMIN

2.1.1 Dorëshkrimi është i koduar dhe ***nuk përmban asnjë shenjë/informatë apo të dhënë që identifikon autorin apo shtëpinë botuese.***

2.1.2 Për secilën lëndë mësimore duhet të dorëzohen ***libri bazë për nxënës (obligativ) dhe libri për mësimdhënësin (obligativ).*** ***Materialet tjera mësimore plotësuese nuk janë obligative.***

2.1.2.1 Libri për mësimdhënësin duhet të përmbajë:

- Udhëzime për zbatimin e metodologjive të ndryshme pedagogjike dhe shembuj për zhvillimin e njësive mësimore në harmoni me librin bazë për nxënës;
- Udhëzime për punë me nxënës me nivele dhe stile të ndryshme të nxënies që ndihmojnë arritjen e rezultateve të të nxënës dhe zhvillimin e kompetencave të përcaktuara me kurrikulë;
- Sugjerime për materiale që mund të përdoren për zhvillimin e njësive mësimore dhe përdorim të burimeve të tjera të informacionit;
- Libri për mësimdhënësin duhet të jetë në harmoni me programin mësimor dhe librin bazë për nxënës.

2.1.3 Dorëshkrimet ***duhet të përmbajnë referenca*** për të dhënat dhe burimet e informacionit që përmban teksti.

2.1.4 Ilustrimet, fotografitë, tabelat, grafikonet dhe lehtësuesit e tjerë pamorë të njësive mësimore ***duhet të jenë kualitative, të kenë rezolucion të mirë, të jenë relevante për njësinë mësimore dhe moshën e nxënësve, të jenë origjinale, jo diskriminuese dhe paragjyquese, si dhe në përputhje me kontekstin kulturor të Kosovës.***

2.2 KËRKESA TË VEÇANTA PËR DORËSHKRIMIN

2.2.1 Teksti shkollor duhet të jetë i përshtatur me qëllimet edukative-arsimore dhe kompetencat e parapara me Kornizën kurrikulare për arsimin parauniversitar.

2.2.2 Teksti shkollor duhet të jetë në përputhje me planin dhe programin mësimor.

2.2.3 Teksti shkollor duhet të jetë në funksion të zotërimit të njohurive, shkathtësive dhe rezultateve të nxënës të parapara për lëndën dhe klasën përkatëse.

2.2.4 Teksti shkollor duhet të ofrojë përmbajtje në përputhje me të arriturat bashkëkohore të fushës së caktuar shkencore, metodologjinë e mësimi të lëndëve dhe përdorimin e terminologjisë profesionale.

2.2.5 Teksti shkollor respekton gjuhën standarde dhe rregullat e drejtshkrimit. Përfshirje mund të ketë vetëm kur përdoren fragmente nga literatura artistike dhe nga tekstet e dialektologjisë.

2.2.6 Teksti shkollor nxit të menduarit aktiv, kritik dhe kreativ të nxënësve.

2.2.7 Aparatura didaktike e tekstit shkollor duhet të jetë në përputhje me kërkesat bashkëkohore për të nxënëit aktiv, kritik dhe kreativ.

2.2.8 Teksti shkollor përmban fjalor për interpretim të fjalëve dhe koncepteve të panjohura.

2.2.9 Teksti shkollor i përshtatet moshës dhe karakteristikave zhvillimore të nxënësve.

2.2.10 Teksti shkollor ka funksion edukativ, që nxit raportin pozitiv ndaj shkencës/diturisë, zhvillimit të identitetit nacional, qytetar e kulturor dhe që promovon barazinë shoqërore.

2.2.11 Teksti shkollor respekton barazinë shoqërore, nuk përmban stereotipet dhe nuk përdor gjuhë diskriminuese.

2.3 TEKSTET PËR KOMUNITETET JOSHUMICË

2.3.1. Tekstet fituese nga ky konkurs, për lëndët e përgjithshme, duhet të përkthehen, të përshtaten dhe të botohen nga shtëpitë botuese edhe në gjuhët e komuniteteve, në përputhje me Kornizën Kurrikulare si dhe planet dhe programet mësimore të Republikës së Kosovës.

2.3.2. Tekstet shkollore për lëndët nacionale të komuniteteve joshumicë, duhet të botohen nga shtëpitë botuese të cilat janë fituese të konkursit për botim të teksteve për lëndët nacionale në gjuhën shqipe (Gjuhë, Art, Muzikë, Histori).

3. PROCEDURA E APLIKIMIT

Faza e aplikimit është e hapur për shtëpitë botuese sipas kërkesave dhe procedurave të paraqitura në këtë konkurs.

Paketa e aplikimit duhet të përfshijë dokumentet e mëposhtme:

- 3.1.1. Dorëshkrimin e koduar të dorëzuar në 6 (gjashtë) kopje fizike të shtypur me ngjyrë dhe në kopje elektronike USB/CD në formatin PDF ose WORD;
- 3.1.2. Formulari i aplikimit i plotësuar nga Shtëpia Botuese (Formulari i ofruar së bashku me këtë konkurs mund të shkarkohet nga ueb faqja e MASHTI);
- 3.1.3. Formulari i aplikimit të plotësuar nga Autori (Aneksi II i ofruar së bashku me Udhëzimet e Aplikimit, shkarkohet nga ueb faqen e MASHTI);
- 3.1.4. Deklaratën nën betim – e nënshkruar dhe e vulosur;
- 3.1.5. Vërtetimin nga Administrata Tatimore;
- 3.1.6. Vërtetimin nga Gjykata themelore;
- 3.1.7. Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- 3.1.8. Regjistrimin e numrit fiskal;

3.1.9. Regjistrimin e TVSH-së.

Paketa e aplikimit duhet të dorëzohet fizikisht. Dorëzimi bëhet në MASHTI në zyrën e Departamentit për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar deri më 16 maj 2023, jo më vonë se në orën 16:00.

Dorëshkrimet duhet të jenë të mbyllura në zarf. Shtëpia botuese mund të konkurrojë vetëm me një dorëshkrim për tekst shkollor dhe material mësimor për klasën dhe lëndën e njëjtë.

Aplikacionet të cilat nuk i përmbajnë dokumentet e mësipërme, si dhe dorëshkrimet që nuk janë në përputhje me dokumentet e përcaktuara në pikën (2), me kërkesat e përcaktuara me pikat (2.1), (2.2) dhe (2.3) të këtij konkursi, nuk do të shqyrtohen.

Pyetjet në lidhje me këtë konkurs mund të dërgohen në gjuhën shqipe, serbe ose angleze në email-in: feime.llapashtica@rks-gov.net, deri më 16 maj 2023. Të gjitha pyetjet dhe përgjigjet si dhe njoftimet tjera të rëndësishme për aplikuesit do të publikohen në ueb faqen e MASHTI jo më vonë se 30 ditë para mbylljes së afatit për dorëzimin e aplikacioneve.